

Punime restauruese në Kishën e Manastirit të Fjetjes së Hyjlindëses në Zvërnec



Në Kishën e Manastirit të Fjetjes së Hyjlindëses, në ishullin e Zvërnecit, po vijon restaurimi, pas ndërprerjes së punimeve, gjatë periudhës së masave të marra kundër COVID-19.

Punimet për restaurimin e radhës të kësaj kishe filluan me projektin e hartuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Ashtu si edhe në restaurimet e mëparshme të bëra në Kishë, realizimi dhe ndjekja e punimeve po kryhet nga Bërthama e Trashëgimisë Kulturore e Kishës, në koordinim dhe bashkëpunim në terren me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Vlorë, si dhe Institutin e Monumenteve.

Punimet u ndërprejnë gjatë periudhës së masave të marra kundër COVID-19 dhe tani po vazhdojnë me ritme normale. Ato konsistojnë në fugatimin e plotë të kishës brenda dhe jashtë, zëvendësimin e elementeve të dëmtuara; pastrimin dhe meremetimin e çatisë, përforcimin e elementeve prej druri etj.

Kjo kishë daton në shek. XIII – XIV, duke u bazuar në trajtimin e fasadave në arkada, si dhe ngjashmërisë me kishën e Shën Kollit në Kurjan të Fierit. Në një mbishkrimin në gur te porta kryesore e hajatit jepet edhe viti 1884. Ky vit ka të bëjë me ndërtimin e hajatit, eksonarteksit dhe kambanores.

— ata.gov.al